

VENDIM
Nr.963, datë 24.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE
TË PROKURIMIT, ME OBJEKT “SHTYPJEN E “FLETORES ZYRTARE” PËR VITIN
2010”, TË KRYERA NGA QENDRA E PUBLIKIMEVE ZYRTARE, SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për përfundimin e procedurave të prokurimit, me objekt “Shtypjen e “Fletore Zyrtare” për vitin 2010”, të kryera nga Qendra e Publikimeve Zyrtare, si autoritet kontraktor, deri më 31.12.2010.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha